

### Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK). Vizioni i kësaj strategjie është krijimi i institucioneve transparente, me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe që garantojnë shërbim cilësor dhe të pa-korrupsionit. Ky vizion është adoptuar në tre qasje, parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere, ndaj korrupsionit.


Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të qasjes ndërgjegjësuere, Ministria e Drejtësisë harton çdo vit Strategjinë e Komunikimit dhe Vizibilitetit në fushën antikorrupsion. Nëpërmjet saj, Ministria synon të arrijë audiencë të ndryshme, brenda dhe jashtë institucioneve shtetërore dhe të ndërtojë një marrëdhënie të re me qytetarët, bazuar në besimin e ndërsjellë për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit. Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

### Aktivitetet përgjatë muajit Dhjetor, 2021

#### Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit denoncon në SPAK dhe Prokurori raste korrupsioni

1-31.12.2021. Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, z. Ulsi Manja ka bërë publike gjatë muajit dhjetor rastet e dërgimit pranë organit të prokurorisë, të zyrtarëve publikë të dyshuar për krimin e korrupsionit. Njësitë Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, nëpërmjet Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion dhe të Drejtorisë Operacionale për Çështjet Antikorrupsion ka finalizuar kontrollet dhe ka depozituar në organin e prokurorisë rastet e nëpunësve të shtetit, që janë gjetur në shkelje dhe në konsumim të veprës penale të korrupsionit dhe të shpërdorimit të detyrës. Rastet janë të shpërndara në institucione që operojnë në të gjithë vendin, si Kadastra e Durrësit, dogana në Korçë, Drejtoria e Transportit Rrugor në Tiranë. Gjithashtu, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit i është drejtuar SPAK-ut për marrjen të pandehur të subjekteve nga radhët e gjyqësorit, pasi është krijuar bindja për dhënien e vendimeve në kundërshtim me interesin publik.

Më shumë informacion mund të gjeni në këtë link: <https://www.drejtësia.gov.al/manja-raste-te-reje-te-zbuluara-nga-njesia-antikorrupsion> dhe <https://www.facebook.com/drejtësia.gov.al>



#### Finalizohet Raporti i Monitorimit të Planit të Veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, për periudhën korrik-shtator 2021

14.12.2021. Sekretariati Teknik i Komitetit Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) dakordësoi përmbajtjen e Raportit 3M3 të Monitorimit për periudhën korrik-shtator 2021, të Planit të Veprimit 2020-2023. Takimi i Sekretariatit teknik u zhvillua online, në prezencë të të gjithë përfaqësuesve teknikë të institucioneve zbatuese të SNKK-së. Raporti i monitorimit jep informacion mbi progresin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të planifikuara për këtë periudhë të planit veprimit, adreson rekomandime për objektivat dhe hapat e tjerë të veprimit. Përgjatë korrik-shtator 2021, janë realizuar plotësisht 29 masa, pjesërisht 22 masa dhe nuk janë realizuar 8 masa, si dhe janë realizuar plotësisht 65 aktivitete, pjesërisht 21 aktivitete dhe të përcaktuara janë 21 aktivitete. Realizueshmëria e qëllimit strategjik ndërinstitucional kundër korrupsionit është në masën 62.85%. Raporti final do të miratohet në mbledhjen e radhës së Komitetit Koordinator për zbatimin e SNKK-së.

Raporti i finalizuar i Monitorimit Korrik-Shtator 2021 mund të aksesohet në këtë link: <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/Draft-Raporti-i-monitorimit-SNKK-Korrik-Shtator-2021.pdf>

#### Java e Integritetit 3: Forum për integritetin me organizatat rinore

06.12.2021. Java e Integritetit, edicioni 3, bashkoi Ministrinë e Drejtësisë me organizatat e të rinjve, aktive në fushën e ndërgjegjësisë publike dhe advokacisë në luftën kundër korrupsionit. Në Ministrinë e Drejtësisë u zhvillua takimi forum për integritetin me organizatat rinore, një takim i hapur bashkëbisedimi, ku Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, z. Ulsi Manja dhe përfaqësues të lartë të fushës antikorrupsion folën dhe promovuan risitë e strukturës antikorrupsion. Qasja e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion me publikun, nismat e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në kuadër të luftës kundër korrupsionit, mënyrat e përdorimit të mekanizmave antikorrupsion si dhe shkëmbim idesh dhe mendimesh për politika dhe iniciativa konkrete kundër korrupsionit, ishin fokusi i takimit.

Më shumë informacion mund të gjeni në këtë link: <https://www.facebook.com/drejtësia.gov.al>




#### Java e Integritetit 3: Forum diskutimi me përfaqësues të biznesit: Ngritja e urave të komunikimit dhe partneriteti me biznesin në luftën kundër korrupsionit

07.12.2021. Java e Integritetit, edicioni 3, bashkoi Ministrinë e Drejtësisë me përfaqësuesit e Dhomave dhe Shoqatave të Biznesit që operojnë në Shqipëri. Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, kërkoi bashkëpunim të ngushtë me Dhomat e Bizneseve me qëllim afrimin e tyre drejt Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit, një strukturë e riorganizuar tashmë në 44 institucione dhe agjenci që ofrojnë shërbime me publikun. Përfaqësues të biznesit adresuan disa prej shqetësimeve të tyre kundrejt njësive dhe punonjësve të administratës publike dhe kërkuan më shumë përgjegjshmëri dhe llogaridhënie. Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, z. Ulsi Manja dhe përfaqësues të lartë të fushës antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë kërkuan bashkërendimin e ndërhyrjeve të tyre dhe garantuan aplikimin e masave ndëshkimore ndaj çdo rasti ankese, për të cilën vërtetohet se ka shkelje të rregullave procedurale në ushtrimin e detyrës. Përfaqësuesve të biznesit iu komunikuan të gjitha kanalet dhe mekanizmat e komunikimit nëpërmjet të cilat ata mund të adresojnë ankesa dhe denoncime të tyre për raste korrupsioni.

Më shumë informacion mund të gjeni në këtë link: <https://www.facebook.com/drejtësia.gov.al>

#### Java e Integritetit 3: Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit partner dhe pjesëmarrës në aktivitetet e fushatës së ndërgjegjësisë kundër korrupsionit

1-10.12.2021. Ministria e Drejtësisë është bashkuar për të tretin vit në aktivitetet e Javës së Integritetit, në cilësinë e institucionit partner. Përfaqësues të lartë të Ministrisë së Drejtësisë, morën pjesë dhe mbajtën kumtesa në aktivitete të organizuara nga organizata vendase dhe të huaja, pjesëmarrëse në këtë fushatë. Përmendim, konferencën e organizuar nga OSBE, "Rritja e ndërgjegjësisë për pabarazitë gjinore dhe korrupsionin", në të cilën u diskutua mbi korrupsionin dhe pabarazitë gjinore, mbi qasjet gjinore në luftën kundër korrupsionit dhe ndikimin e tyre në rritjen socio-ekonomike, forcimin e sigurisë dhe në konsolidimin e demokracisë; në forumin e diskutimit "Integriteti në Arsimit" dhe promovimin e ekspozitës "Korrupsioni ha edhe të zotin" të organizuar nga Qëndresa Qytetare, si dhe Forumin e Këshillit të Parlamentit Rinor Shqiptar. Gjatë Javës së Integritetit, u përgatitën dhe shpërndanë mjaft informacione grafike me të dhëna për luftën kundër korrupsionit.



#### Seanca e Nëntë e Konferencës së Shteteve Anëtare të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC)

13-17.12.2021. Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit mori pjesë në Seançën e Nëntë të Konferencës së Shteteve Anëtare të UNCAC. Fokusi tematik i punimeve të kësaj konference ishte rishikimi i implementimit të konventës nga shtetet anëtare në tërësi dhe kapitujve të veçantë të lidhur me rikuperimin e aseteve, bashkëpunimin ndërkombëtar, parandalimin e korrupsionit dhe asistencën teknike. Konferenca shërbeu si një platformë diskutimi ndërmjet përfaqësuesve të nivelit të lartë të shteteve anëtare. Në nivel politik, Ministria e Drejtësisë u përfaqësua nga Zëvendësministria e Drejtësisë, znj. Adea Pirdeni, e cila mbajti fjalën e saj përshëndetëse në këtë konferencë, duke ri-konfirmuar angazhimin e Shqipërisë për mirë-qeverisje, sundim të ligjit, integritet dhe forcim të bashkëpunimit ndërkombëtar. Në fjalën e saj, znj. Pirdeni përmendi disa prej arritjeve të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, si reforma në drejtësi, përmbushja me sukses të 9 nga 10 rekomandimeve të raundit të katërt të vlerësimit të GRECO-s, si edhe progresin për ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve.

#### Konferenca "Parandalimi administrativ nëpërmjet modeleve antikorrupsion në vendet candidate, APTA –MOD"

03.12.2021. Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, mori pjesë në konferencën përmbylëse të projektit "Parandalimi administrativ nëpërmjet modeleve antikorrupsion në vendet candidate, APTA –MOD", në Perugia, Itali. Projekti ishte një iniciativë e Universitetit të Perugias, me qëllim analizimin dhe evidentimin e kuadrit strategjik dhe të politikave antikorrupsion në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe identifikimin e mekanizmave të luftës kundër korrupsionit. Konferenca bëri bashkë kërkues të fushës, ekspertë dhe të interesuar për çështje të parandalimit administrativ të korrupsionit me fokus të veçantë Ballkanin Perëndimor. Drejtuesja e njësive së programeve antikorrupsion pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, znj. Rovena Prega, bëri një prezantim të strukturës së re antikorrupsion, të rolit specifik në kuadër të planifikimit strategjik politikë-bërës në fushën antikorrupsion si dhe të rolit me karakter ndëshkues të rasteve të korrupsionit në administratën publike në Shqipëri.

Më shumë informacion mund të gjeni në këtë link:

<https://www.montesca.eu/APTA-MOD> dhe <https://www.facebook.com/aptamodproject>

